


Dep. 2-D/DPK Nr. Prot. 01-2887/12  
Date 15.08.2012  
Nr. pages 02

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	15.08.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Gazmend Rushiti Menaxher i Zyrës së Prokurimit në QKUK
CC:	z. Njazi Gashi Qendra Klinike Universitare e Kosovës.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve radiologjike për Diagnostik dhe Onkologji"



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin " Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve radiologjike per Diagnostik dhe Onkologji" " me numër prokurimit 701-12-104-211 ofron këtë:

### OPINION

Ju si autoritet kontraktues Zyra e Prokurimit t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

### A r s y e t i m

Zyra e prokurimit në QKUK, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Shërbime " të procedurës së hapur me nr. prokurimi 701-12-104-211 dhe titull tenderi "Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve radiologjike për Diagnostik dhe Onkologji" në faqen nr.19 Aneks 1 Specifikimet teknike të Detyrueshme ka kërkuar (Mirëmbajtja një vjeçare e aparateve të radiologjisë nënkupton " ndërrimin e të gjitha pjesëve të cilat janë në defekt nëse paraqitet nevoja në secilën pajisje), në Pjesën II. Përshkrimi i Çmimeve , Faqe nr. 45, 46, 47, 48 dhe 49 , është kërkuar që Operatoret Ekonomik për mirëmbajtje dhe servisim të pajisjeve të ofroj çmimet e tyre

në mënyre paushallë dhe njëherë edhe pagesa për servisim dhe mirëmbajtje të pajisjeve të bëhet në bazë të ofertës që e ofron O.E pavarësisht se a do të servisohen pajisjet.

AK me këtë rast ka dështuar të përgatisë një specifikim teknik detal të pjesëve për pajisjet që duhet të servisohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës 12 mujore gjë që kjo është në kundërshtim me nenin 28 LPP-së 04-L/042.

Autoriteti Kontraktues më datë 04.05.2012 ka përgatitur specifikimin teknik formal për këtë tender, hartues i këtyre specifikave është i njëjti person i cili me datën 24.07.2012 caktohet Kryesues i Komisionit për vlerësimin e tenderit ku sipas Udhëzimit Administrativ neni 56 pika 4 kjo është e ndaluar që një person nga një departament i cili ka përgatitë specifikimet teknike nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit vlerësimit.

Zyra e prokurimit në QKUK, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit, të PJESA C, Formulari i dorëzimit tenderit të pika 4 ka plotësuar validitetin e ofertës për një periudhë prej 90 ditë nga data finale për dorëzimin e tenderit gjë që nuk është në përputhje me nenin 20 të Rregullores për Prokurim Publik ngase këtë pikë duhet plotësuar Operatoret Ekonomik.

Gjatë procesit të vlerësimit krahasimit dhe ekzaminimit të tenderit vërtetohet se :

- O.E “ MEDIKA” - Prishtinë - te kërkesat për përshtatshmëri profesionale të neni 7.1 pika 4 është kërkuar Certifikatat e Serviserave – O.E ka ofruar emrat e serverëve ( Driton Konushevc, Yll Bajrami, Bujar Zylfiu, Betim Hashani, Fisnik Lulaj, Laszlo Toth). Në faqe nr 43 O.E në fjalë gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit çmimin e ofertimit e ka ndare në dy pjesë : Shuma e servisimit 788,800.00 € dhe për pjesën e cila nëse priset çmimi prej 170,00.00 €.
- O.E “ MADE COS” – Prishtinë - te kërkesat për përshtatshmëri profesionale të neni 7.1 pika 4 është kërkuar Certifikatat e Serviserave – O.E ka ofruar emrat e serverëve ( Driton Konushevc, Yll Bajrami, Bujar Zylfiu, Betim Hashani, Fisnik Lulaj).

Nga dokumentacioni i ofrimit për këtë tender vërehet se dy O.E ( MEDIKA dhe MADE COS) kanë stafin e serviserave të njëjti i cili shihet më lartë sipas emrit dhe mbiemrit të tyre.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka bere ekzaminimin e dosjeve ofruese dhe informatave të shpalosura nga Administratat Tatimore e Kosovës shihet se operatori MEDICA posedon numrin e serviserave (punëtorëve) në listën e pagave për vitin 2012 të njëjta me dosjen e tenderit, ndërsa tek lista e pagave të operatorit MADE COS nuk figuron asnjë emër i të punësuar sipas dokumentacionit të ofruar në dosjen e tenderit .

Me respekt!